REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 20/17
Datë/Datum. 03.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: Ministria e Administratës Publike (MAP).	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **20/17** e OE **"Uni Project"** - Prishtinë.		
Datë:	03.02.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 00.01.2016 me Nr. **20/17** nga OE **"Uni Project"** - Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare" me numër të prokurimit MAP202/16/202/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administratës Publike (MAP).

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **UNI PROJECT.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		25.01.2017		**25.01.2017**		**03.02.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 20.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 20/17 e parashtruar nga OE **"Uni Project"**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare" LOT 1, 2 dhe 3,** me numër të prokurimit MAP202/16/202/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Administratës Publike (MAP).**
Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Ministrisë së Administratës Publike (MAP).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "Uni Project", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Uni Project"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 1 - Qëllimi;
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 61 – Tenderët jo-Normalisht te ulët;
Neni 69 - Aftësia teknike dhe / ose profesionale;
Neni 72 - Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë;
Neni 3 - i rregullores për çmime Jo-Normalisht te ulëta.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Kompania Uni Project, pas analizimit te teresishem te dokumenteve relevante te tenderit per mirembajtje teknike ne ndërtesat qeveritare per Lot 1, 2 dhe 3 konstaton dhe konsideron se AK-MAP, ka bere shkelje esenciale dhe substanciale te dispozitave ligjore te kornizes ligjore per prokurim publik duke mohuar te drejtat ligjore te kompanise ton ne fitimin e kontrates publike ne menyre te rregullt dhe ligjore.

Pretendimet tona ankimore te drejtuara tek paneli shqyrtues i OSHP-se, jane te njëjta me pretendimet ankimore te drejtuara te AK neper mjet kerkeses per rishqyrtim duke detajizuar shkeljet esenciale te AK-se.

Pikat e ankeses per shkeljet e pretenduara te AK-ja, jane te prezantuara si vijon:

AK-ja, me daten: 06.01.2017, nepermjet email-it zyrtar njofton kompanin Uni Project, me eliminimin nga konkurrenca nepermjet dorëzimit te letres standarde te pasuksesshem dhe ne te njejten date publikon njoftimin per dhenie te kontrates ne portalin e KRPP-se me ane te se ciles eshte shpallur OE fitues per Lot 1, 2 dhe 3 (shih faktin nr. 1 letra standarde per tenderuesin e suksesshem dhe njoftimin per dhenie te kontrates).

Kompania Uni Project, pas publikimit te njoftimit per dhenie te kontrates me daten: 11.01.2017,

pergadit dhe dorezon kerkesen per rishqyrtim tek autoriteti kontraktues duke shprehur mos-pajtimin per arsyet e eliminimit.

Kerkesa per rishqyrtim eshte pergaditur, nënshkruar dhe dorëzuar zyrtarisht duke përdorur formularin per kerkesen per rishqyrtim duke e protokoluar zyrtarisht ne MAP (Shih faktin nr. 2 kerkesa per rishqyrtim e dates: 11.01.2017).

AK-MAP, me daten: 13.01.2017, refuzon kerkesen per rishqyrtim duke mos ofruar asnje fakt permbjatesor te detajizuar dhe ligjor ne refuzimin e pretendimeve ankimore (shih faktin nr. 3 refuzimi i kerkeses per rishqyrtim i dates: 13.01.2017).

Kompania Uni Project nuk i konsideron si valide dhe ligjore konstatimet e MAP, se nuk ka pasur nevoj per hetim ashtu sic kërkohet ne nenin 3 te Rregullores B57 per cmim abnormalisht te ulet per arsye se OE i shpalur fitues MSS, ka ofruar cmim mbi 30% me te lire se kompania e dyte Uni Project ne renditjen e raportit te vlerësimit te ofertave dhe se ka pasur obligim te filloj procedurat e trajtimit te ofertes se MSS, si cmim abnormalisht te ulet dhe te refuzoj oferten e tille.

Kompania Uni Project, nuk i konsideron valide dhe ligjore konstatimet e MAP, per vendimin e Qeverise se Kosoves per pagen minimale per arsye se disa kontrata te personelit inxhinierik te propozuar te OE fitues MSS kane pagen 150 euro, qe i bie se paga e tyre bruto eshte 161.00 euro pra me pak se 170.00 euro sa kërkohet me ligj.

Kompania Uni Project, e konsideron kunderligjore heshtjen e MAP, ne pretendimin tone ankimore te OE fitues MSS ka shelur ligjin e punes duke ofruar personel per orarin zyrtar te punes (08:16), qe ne te njejten kohe punojn si per MSS, ashtu edhe per kompanin Rexha dhe ne post telekom te Kosoves.

Veprimi i till i OE MSS konsiderohet kundërligjor dhe ne kundërshtim te plot me Ligjin e Punes dhe si i till eshte dashur ta trajtoj kete ofert si ofert te papërgjegjshme dhe

AK-MAP, ka shkelur dispozitat ligjore te LPP-se, qe nuk ka ofruar sqarime konkrete gjate procesit te prokurimit ne baze te kerkeses se kompanise Uni Project, per te sqaruar ceshtjen e kontratave te natyres se ngjashme dhe ne arsyetimin e dhene per kete pretendim ankimore ne kerkesen per rishqyrtim eshte i pa bazuar dhe kundërligjor.

Shemin:

Shih me posht argumentet ligjore – pretendimet ankimore te dorëzuara nepermjet kerkeses per rishqyrtim qe ne pajtim me rregullat e reja ligjore te ankesave paraqiten edhe ne ankesen e OSHP, per shqyrtim, shoshitje dhe argumentim me arsyetimin ligjor para marrjes se vendimit përfundimtar nga anetaret e panelit shqyrtues te OSHP-se.

AK-MAP, ka shkelur rregullen nr. 3.1 dhe 3.2 te B57 rregullat per trajtimin e çmimit jonormalisht te ulet per arsye se OE fitues MSS, per Lot 1, 2 dhe 3 eshte shpallur fitues edhe pse oferta financiare e këtij OE konsiderohet cmim jonormalisht i ulet.

Ne baze te nenit 4 per rregullat per tender Jonormalisht te ulet AK-ja, gjegjësisht departamenti i prokurimit eshte dashur te aplikoj proceduren Inter Partes qe te filloj nje hetim dhe shqyrtim te te gjitha elementeve te ofertes financiare te OE fitues MSS per te konstatuar ligjërisht dhe zyrtarisht nese oferta e MSS konsiderohet abnormalisht e ulet ose ofert financiare me cmim te treguar per Lot 1, 2 dhe 3.

Departamenti i prokurimit pran AK-se, nuk e ka aplikuar proceduren inter partes edhe pse ka pasur obligim ligjor ne baz te nenit 61 te LPP-se dhe ne baze te nenit 3.1 dhe 3.2 te rregullave per trajtimin e çmimit abnormalisht te ulet per te vërtetuar dhe konstatuar se çmimin e tregut te shërbimeve per mirëmbajtje teknike por vetem formalisht ka shpallur fitues OE MSS duke bere shkleje te nenit 61 te LPP-se dhe duke i pamundësuar kompanise Uni Project ne vlerësimin e drejt te ofertes tone qe kemi ofertuar ne baze te çmimit te tregut (Shih faktin nr. 4 – neni 3 dhe neni 4 i rregullave per trajtimin e çmimit abnormalisht i ulet).

Ne nderlidhshmeri me piken 8 te kësaj kerkese per rishqyrtim oferta financiare per Lot 1 e OE fitues eshte 33.47% me e lire se sa oferta financiare e kompanise Uni Project, kurse per Lot 2 eshte Lot 34.08% me e lire se sa oferta financiare e kompanise Uni Project dhe per Lot 3 eshte 32.48% me e lire se sa oferta financiare e kompanise Uni Project

Duke marr parasysh përqindjet (%) ndermjet ofertes se OE fitues dhe kompanise Uni Project e ranguar e dyta me radh konstatohet se oferta e kompanise MSS e përmbush kriterin e parapare ne nenin 3.1 dhe 3.2 te rregullave per trajtimin e çmimit jo normalisht te uletdhe si te tilla duhet te refuzohen si oferta te përgjegjshme ashtu sic parashihet edhe ne nenin 61 te LPP-se te Kosoves.

Pas shikimit te dokumentacionit te ofertes se OE MSS, te propozuar per kontrate kompania Uni Project ka vërejtur se te organogrami (struktura e stafit menaxhues per kete kontrat), per Lot 1 ka prezantuar vetem menaxherin e Lot-it mirpo jo edhe stafin zbatues (4 inxhinier dhe 6 punekryes). Mungesa e prezantimit te 10 punetoreve per Lot 1 ne kuadër te propozimit teknik te OE MSS perben mospërmbushje te detyrimeve te dala nga specifikacioni teknik i detyrueshem.

Poashtu ne oferten e tij OE MSS ka prezantuar se do te kryej punen me 3 nderrime mirëpo nuk ka paraqitur stafin zbatues qe do te kryej shërbimet neper Lot-et perkatese, (shih faktin nr. 5 faqe 18 e DT-se ekstraktet perkatese).

Kompania Uni Project nuk pajtohet me konstatimet e anetareve te komisionit per vlerësim te ofertave se kemi ofruar cmim me te lart perkunder faktit qe kemi plotësuar te gjitha kërkesat teknike dhe financiare te AK.

Ne kete drejtim kompania Uni Project ka ofruar cmim te tregut per ofrimit e shervimeve mirëpo per shkak te mos trajtimit te ofertes financiare te OE te shpallur fitues MSS si ofert me cim abnormalisht te ulet sipas rregulles B57 eshte refuzuar padrejtësisht oferta e Kompanise Uni Project.

Ne planin e menaxhimit te OE te shpallur fitues MSS, nuk konstatohet dhe nuk verehet se ka ofruar minimum prej 10 punetore per Lot apo gjithsej 30 punetor per 3 Lot-et, ku ne secilin lot kërkohen 4 inxhinier te lemive perkatese si dhe nga 2 punetore kujdestar per nje nderrim (3 nderrime x 2 punetor = 6 punetore teknik) per Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3 ashtu sic eshte kërkuar ne dosje te tnderit gjegjësisht ne specifikacionin teknik te detyrueshme.

Mungesa e përcaktimit te numrit perfundimtare te personelit konsiderohet shkleje e specifikacionit teknik te detyrueshem si pjes perberse e dosjes se tenderit dhe si e till duhet te trajtohet nga eksperti teknik dhe nga paneli shqyrtues i OSHP-se shkeljet ligjore duke e konstatuar ligjërisht qe oferta e OE te shpallur fitues MSS eshte ofert e papërgjegjshme (shih faktin nr. 6 – plani i menaxhimit te OE fitues MSS).

Ne oferten e OE te shpallur fitues verehen disa kontrata te inxhinierve qe kan kontrata pune me OE fitues MSS edhe me kompani tjera private dhe publike (si kompania Rexha dhe PTK-ja) dhe si rrjedhoj keta inxhinier te propozuar si per Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3 nuk mund ti shpërblej ne te njejten kohe dhe ne te njejtin vend ne 2 kompani private gjegjësisht publike gjate orarit zyrtare ne lokacione te ndryshme te ndërtesave qeveritare.

Prandaj, me Ligjin e Punes por edhe me aktet tjera nenligjore nuk lejohet qe nje person te kete dy vende pune ne te njëjtin orar zyrtar te punes per disa projekte publike ose private njekohesisht. Poashtu ky veprim i OE MSS, bie ne kundërshtim edhe me paragrafin 4 te specifikacioneve teknike te detyrueshme (Shih faqen nr. 27 te DT), ku kërkohet qe shërbimi te ofrohet ne menyre te plot prej ores 08:00-16:00 (shih faktin nr. 7 – ekstrakt i faqes 27 i DT per orarin e punes ne ndërtesat qeveritare).

Propozimi i inxhinierve te till per Lot 1, 2 dhe 3 te tenderit te lartpërmendur eshte ne kundërshtim edhe me specifikacionin teknik te detyrueshem per arsye se AK, ka kërkuar qe OE per te implementuar kontraten duhet te kete ne dispozicion personelin e kërkuar ne orarin zyrtar te punes se institucioneve publike te Kosoves per te përballuar te gjith punen voluminoze per implementimin e projektit ne te gjitha ndërtesat e specifikuara per tri lotet e lartpërmendura.

Ne nderlidhshmeri me piken 13 te kësaj kerkese per rishqyrtim kompania Uni Project kërkon si nga eksperti shqyrtues por edhe nga paneli qe per shkak te shkeljes se dispozitave ligjore te Ligjit te Punes por edhe specifikacionit teknik te detyrueshme si pjes perberese e DT, qe personeli i propozuar nga operatoret ekonomik te jet i pranishem gjate tere orarit zyrtar te punes te konsideroj oferten e OE fitues MSS te papergjegjshem per shkak mos plotësimin e kërkesave teknik/profesionale te potencuara ne nenin 9.1 dhe 9.2 te FDT-se, si ne vijim:

Emri dhe Mbiemri	Mosha	Paga	Titulli dhe vendi i punes
Naser Sudulli	54	150 neto	IDA,Rexha company dhe MSS.
Arsim Nazifi	34	200 neto	Bachelor Ing. Mak. MSS.
Berat Hasani	32	300 neto	Bachelor Ing. elek. Rexha, MSS.
Skender Rogova	51	150 neto	IDE, PTK dhe MSS.
Burim Hasanaj	30	150 neto	Bachelor Ing. nder. Rexha, MSS.
Flamur Selmanaj	30	300 neto	Bachelor Ing. Mak. MSS.
Ardian Miftaraj	25	300 neto	Bachelor Ing. elek. MSS.
Dukagjin Ramqaj	30	250 neto	Master Inxh. Elektr. MSS.
Valmir Krasniqi	29	300 neto	Bachelor Inxh. ndert. MSS.
Besnik Balaj	52	250 neto	Bachelor Inxh. Mak. MSS.
Lujleta Babuni	59	250 neto	IDE, Rexha, dhe MSS 5/3.
Avdi Avdiu	41	300 neto	Bachelor Inxh. Elek. MSS.

Shih faktin nr. 8 – kopjet e kontratave te inxhinierve dhe dokumentet përcjellëse te tyre.

Kompania Uni Project konsideron shkelje serioze te vendimit te Qeverise nr. 4/33 te dates: 17.08.2011, paragrafi 1. Ku ceket se te gjithe te punësuarit mbi moshen 35 vjeq paga minimale duhet te jet minimum 170 euro. Ne dosjen e personelit te propozuar nga OE paga e tyre eshte nen 170 euro, gjegjësisht 150 euro, (shih faktin nr. 9 – vendimi i Qeverise se Kosoves i dates: 17.11.2011) dhe

Kompania uniproject gjate procesit te prokurimit me daten: 22.12.2016 i eshte drejtuar me shkres zyrtare MAP gjegjësisht departamentit te prokurimit per te kërkuar sqarime zyrtare duke përdorur formen e aprovuar nga KRPP-ja, mirëpo AK duke bere shkelje ligjore administrative nuk ka kthyer përgjigje ne pyetjet e parashtruara.

Pyetjet kan te bejn me kapacitet ekonomike financiare sa i perket dëshmive rreth qarkullimit vjetor per tri vitet e fundit dhe ceshtjen per kapacitetin teknik profesional per te ofruar sqarim per shërbime te njëjta (shih faktin nr. 9 – kërkesa per sqarim shtes e dates: 22.12.2016).

Propozim:
Duke u nisur nga prezantimi i argumenteve ligjore me arsyetimin ligjor ne ankes kompania Uni Project kërkon nga paneli shqyrtues i OSHP-se, te beje shoshitjen e fakteve ne menyre ligjore duke marr vendim per te kthyer lenden e kontestuar ne RI-VLERESIM te ofertave, ne menyre qe te detyrohet AK-MAP, te beje vlerësimin e drejt dhe objektiv te ofertave gjate procesit te serishem dhe te Ri-vleresimit te ofertave me anëtar te rinj te komisionit për vlerësimin e ofertave.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 12.12.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Shërbime/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 28.12.2016

Data e hapjes së ofertave .....28.12.2016-14:00^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë kornize – 36 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65.
b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.
c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik I përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit, Aneksi 2(Origjinal).
b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje).

c. Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).
Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm ngatenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.
b. Certifikata e TVSH-së, për kompanitë vendore.
c. Certifikatën me numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës- për kompanitë vendore.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit- (kopje). Kompanitë e huaja, në rast të shpërblimit me kontratë, duhet të regjistrojnë biznesin (përfaqësinë) e tyre në Kosovë.
b. Certifikata e TVSH-së (kopje).
c. Certifikatën me numër fiskal (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2014-2015-2016) ka qenë në vlerë, se bashku ne te tri vitet, prej jo më pak se:
Për lot 1, 350,000.00 Euro
Për lot 2, 400,000.00 Euro
Për lot 3, 400,000.00 Euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
1. Pasqyrat financiare te audituara nga një auditor i licencuar ose deklarata e qarkullimit e dorëzuar pranë Administratës Tatimore te Kosovës.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime te ngjashme gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) në vlerë prej, se bashku ne te tri vitet, prej jo më pak se:
Për lot 1 200,000.00 Euro
Për lot 2 300,000.00 Euro
Për lot 3 300,000.00 Euro

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 apo me shume pjesë (llote), shuma totale e kontratave qe kërkohet për Llotet për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE.
Shembull: nëse shuma totale e kontratave e kërkuar për Lot 1 është 200,000.00 dhe për Lot 2 është 300,000.00 atëherë kërkesa minimale e kontratave te realizuara e cila duhet te përmbushet nga OE është 500,000.00 euro.

Kërkohen minimum:
Inxhinier i ndërtimtarisë
Inxhinier i makinerisë

Inxhinier i elektrikes
Inxhinier i elektronikes
Vërejtje : stafi i cekur ne piken 2 kërkohet për një Lot nëse kompania oferton ne me shume llote nevojitet staf shtese për secilin Lot. (p.sh nëse ofertën për tri llotet duhet ti ketë 3 inxh. te ndërtimtarisë etj)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kopjet e diplomave ,kontratave për stafin qe do te angazhohet. Kopjet e kontratave me referenca për shërbimet kryera.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Uni Poject"	Prishtinë	3,304.00€ LOT I 4,472.20€ LOT II 4,366.00€ LOT III	JO
2.	"Dolphin"	Prishtinë	3,404.30€ LOT I 3,929.40€ LOT II 3,646.20€ LOT III	JO
3.	"MSS Prishtinë"	Prishtinë	2,197.99€ LOT I 2,947.64€ LOT II 2,947.61€ LOT III	JO
4.	"Schafberger"	Drenas	4,720.00€ LOT II	JO
5.	"SCT Kosova"	Prishtinë	158,400.00€ LOT I 194,220.00€ LOT II 216,750.00€ LOT III	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Armend Rugova - Kryetar i komisionit
- Sundim Selmanaj - Anëtar i komisionit
- Valdet Gashi - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 30.12.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....30.12.2016

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....06.01.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	**Uni Poject**	**3,304.00€ LOT I 4,472.20€ LOT II 4,366.00€ LOT III**	**2**

2.	MSS	2,197.99€ LOT I 2,947.64€ LOT II 2,947.61€ LOT III	1
3.	Schafberger	4,720.00€ LOT II	3

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni i vlerësimit te ofertave ka rekomanduar për kontratë OE "MSS", sepse i plotëson te gjitha kriteret e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë dhe ka ofruar çmimin me te lire ne te tri Lotet.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK-ja, nuk i ka respektuar rregullat për çmime Jo-Normalisht te ulëta, ku OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ne te tri lotet qe ka ofertuar ka ofruar çmime nën 30%. Eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim i OE ankues për Lot 1 dhe 3 është i paqëndrueshëm për faktin se sipas rregullores për çmime Jo-Normalisht te ulëta kushti i pare për tu aplikuar kjo rregullore duhet qe te jen tri oferta e ne rastin konkret sipas raportit te vlerësimit janë vetëm dy oferta te përgjegjshme gjë qe nuk mund te aplikohet formula e dhënë ne këtë rregullore.

Ndërsa sa i përket Lot 2, eksperti shqyrtues sqaron se ne Lot 2 i kemi tri oferta te përgjegjshme sipas raportit te vlerësimit, prandaj rregullorja paraqitet si ne vijim:

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	**kushti 1** - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta	**Pranuar 3 oferta**		
2		1. UNI PROJECT	4,472.20	
3		2. MSS	2,947.64	
4		3. SCHAFBERGER	4,720.00	
8		**Total (C2+C3+C4)**	**12,139.84**	
9		**mesatarja (C8/3)**	**4,046.61**	
10	**kushti 2** - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**3,112.78**	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	**kushti 3** – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1)**	**4,024.98**	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar **3 oferta**	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve <u>të përgjegjshëm</u>**	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim	**Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet**	

Sipas tabelës, rezulton se oferta financiare e OE te rekomanduar për kontratë për Lot 2, i përmbush te gjitha kushtet e parapara ne rregulloren për çmime jo-normalisht te ulëta. Eksperti shqyrtues, sqaron se ne këtë rast është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues sepse AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 61 te LPP-se, për faktin se është dashur ti kërkohet sqarim me shkrim OE "MSS", lidhur me çmimin e ofruar për Lot 2. Ne lidhje me rrezulltatin e dhënë ne tabelë eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit 1 te kësaj Rregulloreje është i **ndaluar përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta,** pa e përdorur proceduren *inter partes*. Prandaj, eksperti shqyrtues, sqaron se gjate Rivlerësimit te Lot 2 te respektohet Rregullorja për çmime Jo-Normalisht te ulëta dhe ti kërkohen sqarimet e nevojshme OE "MSS", sepse sipas nenit 4.1 te Rregullores për Çmime Jo-Normalisht te ulëta, Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 te LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 te këtyre rregullave, një tender i tille **nuk mund të refuzohet** pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve te rëndësishme qe shkaktoj tenderin vecenarisht te ulet.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon qe OE i rekomanduar nuk e ka ofruar pagën e punëtorëve sipas vendimit nr. 04/33 te Qeverise se Kosovës. Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit nuk ka kërkuar page për punëtor, ndërsa lidhur pretendimin për pagën neto te ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë dhe kontributeve te cilat duhet te paguhen ku OE ankues pretendon se paga e te punësuarve është nen limitin e vendimit 04/33 eksperti shqyrtues sqaron se kompetente për këtë çështje është Administrata Tatimore e Kosovës.

Poashtu OE ankues pretendon se stafi profesional dhe teknik i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë janë te angazhuar edhe ne kompani tjetra, eksperti shqyrtues sqaron se ne ofertën origjinale OE i rekomanduar për kontratë i ka dorëzuar disa kontrata te punës te lidhura ne mes te OE Rexha Company (i cili nuk është pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit) dhe Naser Surdullit i cili te OE "MSS", është prezantuar si staf profesional. Eksperti shqyrtues lidhur me këtë sqaron se kontrata e punës e Naser Surdullit dhe OE "Rexha Company", është e nënshkruar ne vitin 2010, ndërsa i njëjti sipas dokumentacionit ka nënshkruar kontratë me OE "MSS" ne Nëntor te vitit 2016 për te cilin OE "MSS" është duke i paguar edhe kontributet për te lartpërmendurit. Eksperti shqyrtues, poashtu sqaron se sa i përket pretendimit lidhur edhe me anëtarët tjerë te stafit profesional te cekur ne ankesë, eksperti shqyrtues sqaron se te gjitha kanë kontrata me kohe te caktuar me OE "MSS" (te nënshkruara ne muajin Nëntor te vitit 2016), ku si dëshmi qe i ka angazhuar këta persona OE "MSS", ka ofruar edhe listën e ATK-se, ne te cilin figurojnë se janë paguar kontributet për: Naser Surdullin, Skender Rugoven, Flamur Selmanaj, Avdi Avdiun etj. Prandaj, ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ne lidhje me numrin e kërkuar te stafit profesional dhe teknik, eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar 34 punëtorë, prej te cileve 12 janë inxhinier te profileve te ndryshme, ndërsa pjesa tjetër janë: Teknik, Mirëmbajtës, Zdrukthtar,

Fasader-Muraotr, mjeshtër te instalimeve elektrike, teknik te hidroinstalimeve etj. Prandaj, pretendimi i OE ankues se nuk ka ofruar numër te mjaftueshëm sipas kërkesave te dosjes se tenderit janë te paqëndrueshme sepse sipas kërkesës se dosjes se tenderit OE "MSS", ka ofruar për secilin Lot nga një inxhinier.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar planin e menaxhimit sipas dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar e ka ofruar planin e menaxhimit ne te cilin ka dhënë detaje me te cilat e sqaron se si do te menaxhohet plani i mirëmbajtjes ku nder te tjera ne këtë plan ka bere ndarjen e stafit profesional dhe teknik ne tri ndërrime, prandaj pretendimi i OE ankues se "nuk vërehet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar minimum 10 punëtor për Lot", është i paqëndrueshëm sepse përveç ne planin e mirëmbajtjes OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe listën e stafit siç u përmend edhe me lart, gjithsej 34 punëtor dhe staf profesional.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se gjate fazës se kritereve, kemi kërkuar sqarim ne lidhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne këtë AK-ja, sipas OE ankues nuk i ka kthyer përgjigje, eksperti shqyrtues, sqaron se ne baze te shkresave te lendes OE ankues ka bere kërkesë pran AK-se, me datën: 22.12.2016, ndërsa afati i fundit për sqarim i dhënë ne dosje te tenderit ka qene 23.12.2016 dhe ne baze te shkresa te lendes nuk ka dëshmi se AK-ja i ka kthyer përgjigje OE ankues. Fakti qe data për sqarim te dosjes se tenderit ka qene data 23.12.2016, AK-ja ka qene e obliguar ti kthej përgjigje, prandaj ne këtë rast AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 53 te LPP-se dhe njëherit sqaroj se ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm.
Pyetja e OE ankues ka qene ne lidhje dëshmit e kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe kapacitetin teknik dhe profesional te cilat OE ankues i ka plotësuar përkundër faktit se AK-MAP nuk i ka kthyer përgjigje.

Sqarimi nr.2
Ne fund eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimet ankimore te OE ankues për shkelje te dispozitave te LPP-se te cekura ne ankesë janë pjesërisht te qëndrueshme, andaj eksperti shqyrtues bazuar ne sqarimet e mësipërme vlerëson se Lot 2 duhet te kthehet ne Ri-vlerësim dhe te respektohen ne tërësi dispozitat e rregullores për Çmime Jo-Normalisht te ulëta, ndërsa për Lot 1 dhe 3 te aprovohet vendimi i AK-se për dhënie te kontratës për faktin se AK-ja, e ka respektuar nenin 60 te LPP-se, ku kriter kryesor për dhënie te kontratës ka qene çmimi me i ulet.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Ministria e Administratës Publike (MAP)**, për aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare" LOT 1, dhe 3,** me numër të prokurimit MAP202/16/202/211, i ka respektuar dispozitat e LPP-së, ndërsa për Lot 2 te kthehet ne ri-vlerësim.